



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE  
KOMISIONI I VOTIMIT**

Tiranë, më 15.10.2021

**PROCESVERBAL**

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E  
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKUROR TË  
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Sot, më 15.10.2021. ora 14.06, në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, 1 (një) prokurori pranë gjykatave të apelit si anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe 1 (një) prokurori të Prokurorisë së Përgjithshme si anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Nga lista emërore e nënshkruar vërtetohet se morën pjesë në mbledhje 209 (dyqindënte) prokurorë të të gjitha niveleve.

Pas plotësimit të kuorumit u vazhdua me votimin i cili nisi në orën 11.15 dhe përfundoi në orën 14.05.

➤ U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të shkallëve të para duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit. Nga administrata ishin përgatitur **250** fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 209 (dyqindëntë). Ngelen 41 fletë votimi të papërdorura.

Nga numri total i votave, rezultoi se 204 (dyqindekatër) fletë votimi janë të vlefshme dhe 5 (pesë) fletë votimi janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- Znj. Deniona Katro 48 vota;
- Znj. Elona Alvora, 6 vota;
- Z. Zeqir Hoda, 150 vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, për prokurorit e shkallës së parë kandidati me numrin më të madh të votave, i cili është z. **Zeqir Hoda**.

➤ U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të apeleve duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga administrata ishin përgatitur **250** fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 209 (dyqindëntë). Nga numri total i votave, rezultoi se 192 (njëqindëntëdhjetë) vota janë të vlefshme dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) vota janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton se kandidati z. Ludovik Dodaj ka marrë **192** vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, për prokurorit e Apelit kandidati z. Ludovik Dodaj.

➤ U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të Prokurorisë së Përgjithshme duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga administrata ishin përgatitur **250** fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 209(dyqindëntë). Nga numri total i votave, rezultoi se 195 (njëqindëntëdhjetëepesë) vota janë të vlefshme dhe 14 (katëmbëdhjetë) vota janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton se kandidati Z. Sokol Stojani ka marrë, 195 (njëqindëntëdhjetëepesë) vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, për Prokurorinë e Përgjithshme kandidati z. Sokol Stojani.

Proceverbali mbahet në 2 (dy) kopje, u lexua e u gjet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje

nga Komisioni i Votimit.

Procesverbali, vendimi dhe gjithë materialet e votimit i dorëzohen Prokurorit të Përgjithshëm, sot në datë 15.10.2021.

Procesverbali mbyllet në orën 15.10

### KOMISIONI I VOTIMIT

ANËTAR

THOMA JANO



KRYETAR

ALMA MUÇA



ANËTAR

KUDUSI SHAHU

